




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**



DATË/A:	16.10.2018
REFERENC-Ë:	<b>AKK- DPKPP /03-03-3364/18</b>
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ, Menaxher i Sektorit për Prokurim në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Mytaher HASKUKA Kryetar i Komunës së Prizrenit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Shaip HAVOLLI, Drejtësor i Agjencisë kundër Korruptionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtësor i Departamentit për Parandalimin e Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për matjen e kualitetit të ajrit dhe parametrave meteorologjik në Prizren"

*Inderuar z. Osmankaj,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3 ) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me tenderin me titull "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për matjen e kualitetit të ajrit dhe parametrave meteorologjik në Prizren", me numër të prokurimit: 622/18/7457/121, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/120/121, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

### OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidenteuara në lidhje me tenderin me titull "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për matjen e kualitetit të ajrit dhe parametrave meteorologjik në Prizren", me numër të prokurimit: 622/18/7457/121, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/120/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

### *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 09.10.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-3364/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull “**Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për matjen e kualitetit të ajrit dhe parametrave meteorologjik në Prizren**”, me numër të prokurimit: 622/18/7457/121, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/120/121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, të llojit furnizime, me vlerë të mesme të parashikuar në shumë prej 30,000.00 €.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka konstatuar se tek rubrika ***III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional, në kërkesën 2. është kërkuar si në vijim: Operatori ekonomik do të ofroj pajisje të cilat janë Europiane.***

Agjencia, konsideron se me formulimin e kësaj kërkese Autoriteti kontraktues ka bërë diskriminim territorial në kundërshtim me nenin 7 paragrafët 1,2,3 dhe 4 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik ku në paragafin 1 në mënyrë decidive thuhet se “Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Parografi 2 parashehet se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.

Parografi 3 “pa e cenuar paragafin e mësipërm, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik”.

Në paragafin 4 parashihet se “Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“.

Me formulimin e kësaj kërkesë që ka bërë Autoriteti kontraktues diskriminohen operatorët ekonomik prodhues të këtyre pajisjeve që janë jashtë Bashkimit Evropian dhe në të njëjtën kohë krijojen kushte favorizuese për Operatorët ekonomik të shteteve që janë brenda BE-së.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin **7** Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin **27** Dosja e Tenderit, të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, si dhe nenin **20.8** të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korruptionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njofuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*